MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN DAJÇ, SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Dajç, Shkodër, me objekt: **"**Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike e lejeve të ndërtimit, lejeve te shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimit për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, legalizimin e shtesave në ndërtime, dhënien me qira të objekteve pronë publike, masat për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimi i Auditit të brendshëm " dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.44 , datë 29.03.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 429/5, datë 29.03.2012, dërguar **z. Arben Gjuraj,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

MASA ORGANIZATIVE

1.Të merren masa që në preventivat për përcaktimin e vlerës limit të kontratës për punë publike, të pasqyrohet edhe fondi rezervë deri në masën deri 5% për punime dhe volume të paparashikuara.

Vazhdimisht

2. Të merren masa që në prokurimet për punë publike, komisioni i vlerësimit të ofertave të ketë në përbërjen e tij specialist të fushës së ndërtimit.

Vazhdimisht

3. Të merren masa që në prokurimet për punë publike, operatori ekonomik fitues para lidhjes së kontratës duhet të paraqesë Siguracionin (Polica e Sigurimit), kërkesë kjo e nenit 25 të KPK dhe nenit 6 të KVK.

Vazhdimisht

4. Të merren masa nga Komuna Dajç, zyra e tatim taksave që të hartojë planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në pikën 10 "Kontrolli Tatimor" të UMB e MF nr.655/1, datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takave vendore".

Menjëherë

5. Të merren masa nga Komuna Dajç, zyra e tatim taksave që të hapë kartelat analitike për biznesin e vogël dhe biznesin e madh.

Menjëherë

6. Të merren masa nga Komuna Dajç, zyra e tatim taksave, për aktrakordimet me ZVRRPP Shkodër për periudha mujore dhe vjetore.

Menjëherë

7. Të merren masa nga Komuna Dajç, zyra e tatim taksave, për kontrolle të vazhdueshme në biznesin e vogël dhe biznesin e madh, në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit dhe për rivlerësim xhiroje.

Menjëherë

8.Të merren masa nga Komuna Dajç, zyra e tatim taksave, për licensimin e 36 subjekteve fizike që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe arkëtimi i detyrimeve të tyre.

Menjëherë

9. Nga Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik i Komunës, të hartohen planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e ndërtimit" dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

Menjëherë

10. Të ushtrohen kontrolle të vazhdueshme nga Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik i Komunës, për ndërtimet paleje dhe të mos lejohet fillimi i punimeve nga ana e subjekteve pa u paisur me leje ndërtimit.

Vazhdimisht

11.Të merren masa nga Komuna Dajç, që të ngrihet dhe të funksionojë Policia Komunare.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohen në rrugë ligjore dëmet ekonomike në vlerën totale **335,100 lekë,** të shkaktuara buxhetit të shtetit nga ku:

B.1. Vlera 121,000 lekë, në ngarkim të 2 punonjësve për përdorim të shpenzimeve operative të arsimit për vitin 2011 "Për koktej", në kundërshtim me kërkesat e pikës 88, paragrafi i parë "Funksionimi dhe mirëmbajtja e ambjenteve të arsimit parauniversitar", të UMF nr.4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011, si dhe pa Vendim të Këshillit të Komunës.

Deri në arkëtimin e plotë

B.2. Vlera 124,100 lekë, në ngarkim të 7 punonjësve për pagesë të bërë për shpenzime transporti, kur mungojnë biletat e transportit, veprim ky në kundërshtim me paragrafin e III-të, pika 1, të VKM nr.1118, datë 3.12.2009 "Për disa ndryshime të VKM nr.228, datë 13.04.2001 "Për djetat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jasht vendbanimit të tyre" dhe të pikës 3.3, Kapitulli III-të të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jasht qendrës së punës, brenda vendit".

Deri në arkëtimin e plotë

B.3. Vlera 90,000 lekë, në ngarkim të 3 punonjësve, të cilët në cilësinë e kryetarit dhe anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në prokurimin me objekt "Blerje makinë teknologjike për pastrimin e mbeturinave", nuk kanë negociuar çmimin e makinës me operatorin [redacted] në kundërshtim me shkronjën "e", pika 4, Kreu V-të të VKM

nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Arkëtimi i vlerave të mësipërme të bëhen sipas listës përkatëse.

Deri në arkëtimin e plotë

C.MASA DISIPLINORE.

C.1. Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ”Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratat individuale të punës, nenit 72 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i kërkojmë APP dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

-***“Vërejtje me Paralajmërim”***

1…[redacted] me detyrë Përgjegjëse e zyrës së financës, në cilësinë e kryetares së komisionit të prokurimeve me vlerë të vogla dhe anëtare e njesisë së prokurimit, sepse:
-në cilësinë e kryetares së komisionit të prokurimeve me vlerë të vogla, për vitin 2010 e 2011, në 13 raste në vlerë 1,964,962 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 2 “Prokurimi me vlerë të vogla”, të Kreut VI-të të VKM nr.1, datë 10.1.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5 të UAPP nr.2, datë 18.02.2008 “Për Procedurat me vlerë të vogla”.
-në cilësinë e anëtares të njesisë së prokurimit në 4 prokurime të vitit 2010 me fond limit 29,012,142 lekë dhe në 2 prokurime për 9-mujorin e vitit 2011 me fond limit 16,520,000 lekë, llogaritja e fondit limit për punët publike dhe mallra në të gjithë prokurimet nuk është argumentuar ligjërisht; Urdhëri i Prokurimit është hartuar duke mos zbatuar kërkesat e pikës 2 shkronja “a” të Kreut II-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar; procesberbali për miratimin e DT, nuk është hartuar siç përcaktohet në pikën 2 shkronja “a” të Kreut V-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007 dhe DT nuk janë firmosur nga njesia e prokurimit; komisioni i vlerësimit të ofertave është ngritur në kundërshtim me pikën 2 shkronja “ç” të Kreut V-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007, sepse në përbërjen e tij nuk ka specialist të fushës së prokurimit.
2[redacted] me detyrë përgjegjëse e zyrës së urbanistikës, në cilësinë e anëtares të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogla dhe të njesisë së prokurimit sepse:
-në cilësinë e anëtares së komisionit të prokurimeve me vlerë të vogla, për vitin 2010 e 2011, në 13 raste në vlerë 1,964,962 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 2 “Prokurimi me vlerë të vogla”, të Kreut VI-të të VKM nr.1, datë 10.1.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5 të UAPP nr.2, datë 18.02.2008 “Për Procedurat me Vlerë të Vogla”.
-në cilësinë e anëtares së njesisë së prokurimit, në 4 prokurime të vitit 2010 me fond limit 29,012,142 lekë dhe në 2 prokurime për 9-mujorin e vitit 2011 me fond limit 16,520,000 lekë, llogaritja e fondit limit për punët publike dhe mallra në të gjithë prokurimet nuk është argumentuar ligjërisht; Urdhëri i Prokurimit është hartuar duke mos zbatuar kërkesat e pikës 2 shkronja “a” të Kreut II-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar; procesberbali për miratimin e DT, nuk është hartuar siç përcaktohet në pikën 2 shkronja “a” të Kreut V-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007 dhe DT nuk janë firmosur nga njesia e prokurimit; komisioni i vlerësimit të

ofertave është ngritur në kundërshtim me pikën 2 shkronja “ç” të Kreut V-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007, sepse në përbërjen e tij nuk ka specialist të fushës së prokurimit.

3. [redacted] me detyrë juriste, në cilësinë e anëtares të njesisë së prokurimit, sepse:

-në 4 prokurime të vitit 2010 me fond limit 29,012,142 lekë dhe në 2 prokurime për 9-mujorin e vitit 2011 me fond limit 16,520,000 lekë, llogaritja e fondit limit për punët publike dhe mallra në të gjithë prokurimet nuk është argumentuar ligjërisht; Urdhëri i Prokurimit është hartuar duke mos zbatuar kërkesat e pikës 2 shkronja “a” të Kreut II-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar; procesberbali për miratimin e DT, nuk është hartuar siç përcaktohet në pikën 2 shkronja “a” të Kreut V-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007 dhe DT nuk janë firmosur nga njesia e prokurimit; komisioni i vlerësimit të ofertave është ngritur në kundërshtim me pikën 2 shkronja “ç” të Kreut V-të të VKM nr.1, datë 10.01.2007, sepse në përbërjen e tij nuk ka specialist të fushës së prokurimit.

-në prokurimet “Rikonstruksion i rrugës Samrisht i Ri” dhe “Asfaltim rruga e Sukave, pjesa II-të” operatori ekonomik fitues përpara lidhjes së kontratës nuk ka paraqitur Siguracionin (Polica e Sigurimit), në kundërshtim me nenin 25 të KPK dhe nenin 6 të KVK.

4. [redacted]**,** me detyrë ish zv/kryetar komune, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse:

-në 4 prokurime të vitit 2010 me fond limit 29,012,142 lekë dhe në 2 prokurime për 9-mujorin e vitit 2011 me fond limit 16,520,000 lekë, ka kualifikuar operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikën 3.7 të pikës 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të DT;

-në prokurimet “Rikonstruksion i rrugës Samrisht i Ri” dhe “Asfaltim rruga e Sukave, pjesa II-të”, ka kualifikuar operatorët në kundërshtim me pikën 3.12 të pikës 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të DT;

- nuk ka hartuar procesverbalin për vlerën anomalisht të ulët, në kundërshtim me shkronjën “ë”, pika 4, Kreu V-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

- ka hartuar Raportin Përmbledhës në kundërshtim me shkronjën “gj”, pika 4, Kreu V-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

5. [redacted] me detyrë ish Përgjegjës i zyrës së taksave e tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse:

-në 4 prokurime të vitit 2010 me fond limit 29,012,142 lekë, ka kualifikuar operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikën 3.7 të pikës 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të DT;

-në prokurimet “Rikonstruksion i rrugës Samrisht i Ri”, ka kualifikuar operatorët në kundërshtim me pikën 3.12 të pikës 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të DT;

- nuk ka hartuar procesverbalin për vlerën anomalisht të ulët, në kundërshtim me shkronjën “ë”, pika 4, Kreu V-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

6. [redacted] **,** me detyrë sekretare e këshillit të komunës, në cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse:

-në 4 prokurime të vitit 2010 me fond limit 29,012,142 lekë dhe në 2 prokurime për 9-mujorin e vitit 2011 me fond limit 16,520,000 lekë, ka kualifikuar operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikën 3.7 të pikës 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të DT;

-në prokurimet “Rikonstruksion i rrugës Samrisht i Ri” dhe “Asfaltim rruga e Sukave, pjesa II-të”, ka kualifikuar operatorët në kundërshtim me pikën 3.12 të pikës 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të DT;

- nuk ka hartuar procesverbalin për vlerën anomalisht të ulët, në kundërshtim me shkronjën "ë", pika 4, Kreu V-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

7. [redacted] në cilësinë e anëtares të komisionit të blerjeve me vlerë të vogla dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave sepse:

-në cilësinë e anëtares së komisionit të prokurimeve me vlerë të vogla, për vitin 2010 e 2011, në 13 raste në vlerë 1,964,962 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 2 "Prokurimi me vlerë të vogla", të Kreut VI-të të VKM nr.1, datë 10.1.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe të pikës 5 të UAPP nr.2, datë 18.02.2008 "Për Procedurat me Vlerë të Vogla".

-në cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave në 1 prokurim të vitit 2010 me fond limit 17,633,145 lekë dhe në 1 prokurim për 9-mujorin e vitit 2011 me fond limit 1,200,000 lekë, ka kualifikuar operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikën 3.7 të pikës 3 "Udhëzime për operatorët ekonomikë" të DT;

-në prokurimet "Rikonstruksion i rrugës Samrisht i Ri", ka kualifikuar operatorët në kundërshtim me pikën 3.12 të pikës 3 "Udhëzime për operatorët ekonomikë" të DT;

- nuk ka hartuar procesverbalin për vlerën anomalisht të ulët, në kundërshtim me shkronjën "ë", pika 4, Kreu V-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

8. [redacted] në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlerë të vogla dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave sepse:

-në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogla, për vitin 2010 e 2011, në 13 raste në vlerë 1,964,962 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 2 "Prokurimi me vlerë të vogla", të Kreut VI-të të VKM nr.1, datë 10.1.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe të pikës 5 të UAPP nr.2, datë 18.02.2008 "Për Procedurat me Vlerë të Vogla".

-në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në 2 prokurim të vitit 2010 me fond limit 11,400,000 lekë, ka kualifikuar operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikën 3.7 të pikës 3 "Udhëzime për operatorët ekonomikë" të DT;

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatos Gjyrezi dhe Ramadan Zejnuni. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT